



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2018, miratoi këtë

V E N D I M

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2018 DHE RREGULLORES PËR PUNËN E KUVENDIT DHE TË KOMITETEVE

I. Miratohet Vendimi për formimin e grupi punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018 dhe Rregullores për punën e Kuvendit dhe të komiteteve.

II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit,
2. Egzon Azemi, LVV, anëtar,
3. Agim Gashi, LDK, anëtar,
4. Leutrim Retkoceri, PDK, anëtar,
5. Valbona Ajeti, AAK, anëtare,
6. Arbenita Murseli, AKR-AA, anëtare,
7. Bukurie Canolli, LB, anëtare,
8. Baton Dushi, NISMA, anëtar,
9. Nol Nushi, LVV, anëtar,
10. Florina Rrahmani, përfaqësuese e Zyrës ligjore, anëtare,
11. Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,
12. Zijadin Gashi, përfaqësues i Sektorit për punë të Kuvendit, anëtar.

III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018 dhe Rregullores për punën e Kuvendit dhe të komiteteve.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-020/01-57668/18, më 09.03.2018



KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

Adresa: Rr. UÇK-2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>